

FINANCA & EKONOMIA

Ditari Mujor | Gusht 2022

BAROMETRI EKONOMIK



15.9%

u rritën të ardhurat në 7-mujorin e vitit 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



15,108

më shumë vende pune në qershor 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



4,111

biznese më shumë në korrik 2022 krahasuar me korrikun 2021.



+10.7%

biznese të reja më shumë në 7-mujorin e vitit 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



22%

u rrit qarkullimi total sipas sektorëve. Është rritur me më shumë krahasuar me 7-mujorin e vitit të kaluar



Barometri i Ballkanit: Shqipëria, me procedurat më të shpejta doganore të import-eksporteve

“Balkan Barometer Business Opinion 2022”, realizuar nga Regional Cooperation Council (RCC) me financimin e Bashkimit Evropian (BE) vlerëson progresin e procedurave në shërbim të biznesit të Doganave Shqiptare. Edicioni 2022 i Barometrit të Ballkanit- Regional Cooperation Council i Balkan Barometer Business Opinion 2022 (rcc.int), vlerëson perceptimet e biznesit nëpërmjet një pyetësori me 177 pyetje drejtuar 1203 përfaqësuesve të biznesit, edhe sa i përket procedurave doganore për importet dhe eksportet. Sipas Barometrit, “në rajon Shqipëria duket që ka procedurat më të shpejta doganore të importeve në dogana me më pak se dy ditë (për më shumë se 50 % të importuesve), dhe për eksportet në më pak se dy ditë, ndërkohë që për vendet e tjera koha doganore e çlirimit të mallrave për eksport është 3-5 ditë. Sipas sondazhit, eksportuesit janë shprehur për rënie të barrierave në formën e uljes së kërkesave për dokumentacion dhe leje e licensa (16 %) dhe dokumentacion shkresor (15 %), të cilat kanë rënë ndjeshëm që nga viti 2020. Kjo shpjegohet me disa nisma të integritit rajonal, të cilat janë diskutuar dhe promovuar gjatë vitit 2021. Pozitiv është konkluzioni i Barometrit se “Shqipëria nuk është në listën e vendeve që kërkon dokumentacion shkresor (Dogana shqiptare funksionojnë nëpërmjet sistemeve informatike dhe janë paper-less).

Performanca Paraprake 7 mujore e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat totale për 7 mujorin e vitit 2022 u realizuan në masën 104 % të planit të 7 - mujorit. Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e shtatë të vitit 2022, arritën në rreth 311 miliard LEK me një realizim në masën 87 % të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ky zë ka rezultuar 567 milion LEK më pak. Niveli i suficitit për periudhën 7 mujore të vitit 2022 rezultoi në rreth 15.735 miliard LEK. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku niveli i deficitit rezultonte në masën prej rreth 29.8 miliard LEK.

Mbështetje për nxënësit e arsimit të mesëm profesional

Arsimi profesional ka pasur një vëmendje të shtuar të MFE në vitet e fundit dhe është një zgjedhje e cila mundëson një integrim të shpejtë në tregun e punës. Është rritur mbështetja për nxënësit që ndjekin shkollat profesionale. Mbi 2500 bursa studimi deri në 7320 lekë ofrohen për të rinjtë që ndjekin shkollën profesionale. Përmes këtyre bursave mbështeten një sërë kategorish të nxënësve, si: vajzat; nxënësit që regjistrohen në degët prioritare; nxënësit nga familjet në nevojë që banojnë mbi 5 km larg nga shkolla profesionale; ekselentët që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës në arsim profesional me notë mesatare mbi 9; nxënësit nga grupet e veçanta.

Moody's rikonfirmon për ekonominë shqiptare vlerësimin në “B1 – me perspektivë të qëndrueshme”

30 gusht 2022

Në “rifreskimin” më të fundit të opinionit të saj publikuar më 30 Gusht 2022, agjencia ndërkombëtare e vlerësimit të kredibilitetit “Moody's” ri-konfirmon vlerësimin aktual të Shqipërisë, “B1 – me perspektivë të qëndrueshme”. Agjencia ka rishikuar për lart parashikimin e saj për rritjen reale ekonomike të vitit 2022 në 3.8% (nga 3.4% që ishte parashikimi i mëparshëm në fillim të Prillit). Agjencia është e opinionit se hapja formale e negociatave të anëtarësimit është mjaft pozitive për Shqipërinë, sepse do të nxisë zbatimin e reformave dhe do të mbështesë fuqinë institucionale të vendit. Agjencia parashikon që ky zhvillim do të përmirësojë mjedisin e përgjithshëm të biznesit dhe gjithashtu do të rrisë nivelet e Investimeve të Huaja Direkte (IHD).

Politikat e ndërmarrja nga qeveria ndikuan pozitivisht në ekonomi

Ekonomia e vendit po ecën me ritme pozitive, e mbështetur nga politikat dhe masat e ndërmarrja nga qeveria, të cilat kanë synuar mbështetjen e shtresave më në nevojë dhe minimizimin e efekteve negative të agresionit rus mbi Ukrainë dhe krizës së rritjes së çmimeve. Në konferencën e përmuajshme për shtyp, Ministria e Financave dhe Ekonomisë bëri një prezantim dhe analizë të treguesve

kryesorë më të fundit të ekonomisë. Falë masave të ndërmarrja është bërë e mundur që niveli i inflacionit në vend të jetë i kontrolluar, ku për muajin korrik 2022 rezultoi të jetë 7.5 %, ndërkohë që për 7 mujorin inflacioni mesatar ka qenë në vlerën 5.3 %, më i ulët se sa në vendet e tjera të rajonit dhe mesatarja e vendeve të BE.

▶ LEXO MË SHUMË



Zbatimi i politikave të strehimit social

Enti Kombëtar i Banesave, përmes investimeve të buxhetit të shtetit, ka bërë të mundur që 210 apartamente me kosto të ulët

të jenë gati për të mundësuar strehimin e familjeve që nuk kanë mundësi dhe aftësi paguese të blejnë në treg të lirë. Nga këto apartamente do të përfitojnë 75 familje në Vlorë; 40 familje në Gramsh; 25 familje në Maliq dhe 70 familje në Kukës. Ndërkohë, EKB vijon procesin e privatizimit të banesave nga poseduesit e ligjshëm dhe vetëm në 6 mujorin e parë janë realizuar 51 privatizime.

Marrëveshje për financimin shtesë të rrugës Qukës-Qafë Pllaçë



Përmirësimi i infrastrukturës dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore janë një ndër prioritetet e Qeverisë shqiptare, në kuadër edhe të integritit rajonal dhe europian. Ministria Delina Ibrahimaj dhe drejtori Ekzekutiv i Fondit Saudit të Zhvillimit, Abdulrahman

Al-Marshad, nënshkruan marrëveshjen për financimin e shtesës së huasë, për projektin e ndërtimit të rrugës Qukës-Qafë Pllaçë. Financimi do të jetë në vlerën 49 milionë dollarë, ndërsa më herët janë dhënë edhe 25 milionë dollarë. Segmenti prej 43 kilometrash i rrugës Qukës Qafë-Pllaçë është pjesë e korridorit rrugor Tiranë – Korçë dhe parashikon të ulë me 1 orë rrugën nga kryeqyteti për në juglindje.

▶ LEXO MË SHUMË



Nisi në 1 Gusht 2022 zbatimi i marrëveshjes për sigurimet shoqërore me Kanadane. Rreth 30-40 mijë shqiptarë të cilët jetojnë dhe punojnë në këtë vend pritet të përfitojnë. Kjo marrëveshje e ratifikuar në vitin 2019 synon trajtimin e barabartë të qytetarëve dhe njohjen e periudhave të vjetërsisë në punë.